

## Kosove/ Anullohet takimi ne FIFA

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 28 Nentor 2013 18:10

---



Federata Futbollit te Kosoves dhe drejtuesit e saj njoftojne se FIFA ka kerkuar qe takimi i rradhes midis drejtuesave te FFK-se, FIFA-s dhe FSF-se te zhvillohet ne nje date tjeter. Takimi ishte planifikuar per tu zhvilluar me 29 Nentor ne Zurih. “Mbrëmë vonë ka arritur letra nga FIFA se takimi i paraparë për nesër më 29 nëntor, ndërmjet FIFA-s, FFK-së dhe Federatës serbe është shtyrë për një kohë tjetër. Kështu që delegacioni i FFK-së me gjithë përgatitjet ka anuluar udhëtimin për ne selinë e FIFA-s në Zurich”, thuhet në njoftimin e FFK-së.